



02/ 9667 2023  
13.11.2023

Duke u bazuar në nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publikë nr. 08/L-197, Ligjit , nenit 8 të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr.03/L-212, Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L-125 nenit 69 pika 1.1. Udhëzimin Administrativ(MSH) Nr.04/2020 Kujdesi Parësor Shëndetësor 15 pika 1.2 . Udhëzimit Administrativë nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kryetari i Komunës në Hani i Elezit Shpall këtë:

## KONKURS

### PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

**Titulli i vendit të punës: Mjekë-e të Mjekësisë Familjare**

**Institucioni:** Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr.Menduh Kaloshi”Hani i Elezit

**Drejtoria:**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

**Lloji i pozitës:** Nëpunës i Shërbimit Publik

**Numri i Pozitave:** (2) Dy

**Titulli i mbikëqyrësit:**Drejtori i QKMF-së

**Grada/Koeficienti:**Koeficienti H 10-7.4

**Kohëzgjatja e Kontratës:** (pa afat)

**Orët e punës:**40

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Ndhmon dhe siguron mirësjellje e kujdes të veçantë në lëmin të cilën është trajnuar.
2. Mban evidencën e rregullt të dokumentacionit mjekësorë,kartelën e pacientit si dhe dokumente të tjera.
3. Jep udhëzime me gojë dhe me shkrim për trajtime të pacientit .
4. Merr pjesë në hartimin e planit dhe programit në vendin e punës ku punon.
5. Mban kujdestarinë e radhës dhe kryen punë tjera sipas kërkesës së eprorit.
6. Kujdeset për shëndetin e pacientëve,përshkruan dhe administron tretmanët,medikamentet dhe i aplikon masat tjera shëruese.
7. Ndhmon në preventivin e sëmundjeve dhe çrregullimeve duke këshilluar pacientët në lidhje me dietën ushtrimet ,higjienën dhe shëndetin në përgjithësi.
8. Të raporton për lindjet,vdekjet,sëmundjet ngjitëse autoriteteve kompetente.
9. Të i referon pacientët tek specialistët mjekësorë dhe të shkëmben me ta të dhënat mjekësore.
10. Të përpilon raporte me shkrim lidhur me punën dhe veprimet e tije.
11. Të kryen edhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitetin e lartë në punë.

#### **Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar,kanë mbaruar Fakultetin e Mjekësisë së Përgjithshme dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave të punës.

**Dokumentet e nevojshme:**

- Dëshminë për shkollimin e mbaruar Diploma (e vërtetuar).
- Licenca (e vërtetuar).
- Certifikatën që nuk është nën Hetime (nga Gjykata).
- Certifikatën mbi gjendjen shëndetësore (për arsye të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve kërkohet në fund të procedurës së rekrutimit vetëm nga kandidati më i suksesshëm)
- Letërnjoftimi Kopje
- Dëshmi mbi përvojën e punës(nëse ka).
- Kualifikime tjera (Trajnime).

Periudha e kontratës: 6 muaj punë provuese me mundësi vazhdimi në bazë të rezultateve në punë.

**Afati dhe mënyra e aplikimit:**

Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda 30 ditëve nga data **13.11.2023** deri **12.12.2023 (16:00)**.

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit e marrin pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend.

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatet nga lista e ngushtë.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në tabelën e shpalljes.



Kryetari i Komunës

Mehmet Ballazhi